

PËR

PROJEKTENDIMIN

“PËR

PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE
AEROPORTUALE”**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave për zhvillimin e zonave aeroportuale” iniciohet me qëllim përcaktimin e rregullave mbi kontrollin e zhvillimeve në lidhje me ndikimet që mund të kenë në sigurinë në operim, menaxhimin e botës shtazore, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në aktivitetet ajrore sportive, ndërtimet e propozuara apo përdorimi i tokës, në zonat e mbrojtura të aeroportit dhe jashtë saj, e cila përbën dhe zonën aeroportuale.

Nevoja për përcaktimin e rregullave për zhvillimin e zonave aeroportuale vjen duke pasur parasysh zhvillimin që ka marrë transporti ajror, fluksin e shtuar të fluturimeve për shkak të zhvillimit të turizmit dhe detyrimin që në çdo kohë zonat aeroportuale të jenë të sigurta duke kontrolluar të gjithë perimetrin në këto zona, duke filluar nga zhvillimi i aktiviteteve deri tek ndërtimet që kryhen në zonat aeroportuale.

Përaktimi i katër rregullave dhe ndjekja e një procedure më rigorozë për dhënien e lejeve të ndërtimit në këto zona, do të sillte kontroll të shtuar sa i takon mbrojtjes së objekteve të ndjeshme, si kullat e kontrollit të trafikut ajror, qendrat e komunikimit dhe zonat e magazinimit të karburantit.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTË TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2024.

Relacion për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave për zhvillimin e zonave aeroportuale”

PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim do të përbente një risi në kuadrin rregullator aktual të fushës së transportit ajror dhe të procedurës së dhënies së lejeve të ndërtimit në zona aeroportuale.

Fillimisht për herë të parë, nëpërmjet këtij projektvendimi përcaktohet në bazë të një shtrirje territoriale zona aeroportuale, ku distanca është e ndryshme në bazë të aeroporteve të vendit.

Ky projektakt do të bënte të mundur ndërtimin e kontrolluar në këto zona, duke kufizuar lartësisë e objekteve që mund të ndërtohen apo zhvillohen. Ky kufizim vjen me qëllim dhënien e një siguri shtesë të avionëve që do të operojnë në këtë zonë, duke mos krijuar pengesa të mundshme në fushëpamje apo lëvizshmëri. Procesi i marrjes së lejeve në këto zona parashikohet të ndiqet nga KKTU dhe rrjedhimisht procesi i miratimit të lejeve do të jetë më rigoroz duke kërkuar përbushjen e kushteve të veçanta sipas parashikimeve në Vendimin nr. 408/2015, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet që në zonat aeroportuale tipologjia e ndërtimeve të mund të përfshijë një sërë elementësh të ndryshëm që ndërlidhen me njëri-tjetrin me qëllim kryesor krijimin e sigurisë së operacioneve ajrore dhe ndikimit të kushteve të ndërtimit në aspektin estetik.

Disa prej tipologjive të ndërtimeve që mund të merren në konsideratë për t'u zhvilluar në zonat aeroportuale janë:

- ndërtime të ulëta për të shmangur ndikimin e tepër visual dhe për të ndihmuar në sigurinë ajrore;
- ndërtime me arkitekturë racionale dhe e përshtatshme me mjedisin, për mos të krijuar ndërtime të llojeve të ndryshme të cilat krijojnë pamje jo të këndshme, si dhe ndikojnë negativisht në mjedis;
- gjithashtu synohet që ndërtimet të jenë estetike me qëllim, duke filluar nga përdorimi i ngjyrave dhe materialeve të përshtatshme për mjedisin që e rrëthon, përdorimi i ndriçimit të përshtatshëm për të përmirësuar pamjen dhe rritjen e sigurisë, mirëmbajtjen e përditshme të ndërtimeve për të siguruar që ato të ruhen në gjendje të mirë, si dhe dizajni i ndërtimeve të jetë modern dhe minimalist duke ndërtuar struktura që përpunohen dhe me përdorimin teknologjik të cilat ndihmojnë në minimalizimin e ndikimit vizual.

HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 28, të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është i përbërë nga 16 pika gjithsej, me përbajtjen si më poshtë vijon:

Pika 1 parashikon qëllimin e këtij vendimi, i cili është përcaktimi i rregullave mbi kontrollin e zhvillimeve në lidhje me ndikimet që mund të kenë në sigurinë në operim, menaxhimin e botës shtazore, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në aktivitetet ajrore sportive, ndërtimet e propozuara apo përdorimi i tokës, në zonat e mbrojtura të aeroportit dhe jashtë saj.

Në pikën 2 në përputhje me Kodin Ajror dhe në kuptim të këtij vendimi parashikohet se zona e mbrojtur e aeroportit, nënkupton zonën territoriale e cila shtrihet në një rrëze prej 15 km nga pika e referimit të aeroportit.

Për të bërë më të qartë pikën 2, në pikën tre është bërë përcaktimi për Pikën e Referimit të Aeroportit, e cila është vendndodhja gjeografike e përcaktuar me koordinata sipas sistemit WGS- 84 për një aeroport, sipas Informacionit të Publikimit Aeronautik Shqiptar (AIP).

Në pikën 4 parashikohet se përjashtohen përzbatimin e këtij vendimi, aeroportet që përdoren ekskluzivisht për qëllime ushtarake.

Në pikën 5, në përputhje me Kodin Ajror, parashikohet që jashtë zonës së mbrojtur të aeroportit, leja e ndërtimit për objektet të cilat tejkalojnë lartësinë 100 (njëqind) metra mbi sipërsaqen e tokës, jepet vetëm pas dhënies së pëlgimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

Relacion për projektvendimin "Për përcaktimin e rregullave për zhvillimin e zonave aeroportuale"

rregullave në zonën e mbrojtur të aeroportit dhe për objektet jashtë saj sipas pikës 5, është Ministria përgjegjëse për transportin ajror, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe autoritetet kompetente për kontrollin e territorit.

Në pikën 7 parashikohet që leja për zhvillim apo ndërtim në zonat e mbrojtura të aeroportit dhe për objektet jashtë saj sipas pikës 5, morret pranë KKTU-së, sipas parashikimeve në Vendimin c Këshillit të Ministrave nr. 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

Në pikën 8, përcaktohet që Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia për Zhvillimin e Territorit marrin mendimin e Autoritetit të Aviacionit Civil për cdo praktikë aplikimi për leje zhvillimi, leje ndërtimi apo praktikë hartimi dokumentash për planifikim të territorit, që përmban objekte, struktura apo instalime që ndodhen në zonat e mbrojtura të aeroportit dhe për objektet jashtë saj sipas pikës 5, të këtij vendimi.

Në pikën 9 parashikohet që çdo objekt apo strukturë e planifikuar për ndërtim apo instalim, në zonat e mbrojtura të aeroportit dhe për objektet jashtë saj sipas pikës 5, duhet që të marrë sipas rastit miratimin ose pëlgimin nga AAC.

Pika 10 përcakton se objektet, strukturat apo instalimet do t'i njoftohen AAC-së në lidhje me lartësinë, koordinatat dhe strukturën apo llojin e ndërtimit. Koordinatat e përdorura duhet të janë në formatin WGS84.

Në pikën 11 është përcaktuar që zhvillimi, ndërtimi ose përdorimi i pasurive të paluajtshme, brenda zonës së mbrojtur të aeroportit, për aktivitete apo veprimitari të cilat mund të tërheqin botën shtazore, do t'i njoftohen për vlerësim AAC-së. AAC jep vlerësimin brenda 10 ditëve nga bërja e kërkesës.

Në pikën 12 është parashikuar që AAC përcakton nëse objektet apo strukturat e planifikuara për ndërtim apo instalim në zonat e mbrojtura dhe për objektet jashtë saj sipas pikës 5, të këtij vendimi, janë objekte të rrezikshme për shkak të vendndodhjes, lartësisë ose mungesës së shëniimit apo ndriçimit të tyre. Për këtë qëllim subjektet zhvilluese të cilat marrin vlerësimin pozitiv nga AAC, duhet të njoftojnë këtë të fundit mbi fillimin e punimeve dhe përfundimin e tyre.

Në pikën 13 parashikohet që AAC, shprehet brenda 10 ditëve nga dita e bërjes së kërkesës sipas pikave 8 dhe 9 të këtij vendimi. Nëse AAC, nuk shprehet brenda 10 ditëve, kërkesa quhet e pranuar dhe pavërejtje.

Pika 14 përcakton që në çdo rast, subjektet që kërkojnë të bëjnë zhvillime ose ndryshime në pasuritë apo objektet që kanë në pronësi, duhet të ndjekin procedurën e parashikuar në VKM nr. 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, pranë KKTU-së.

Relacion për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullores për zhvillimin e zonave aeroportuale”

“Për përcaktimin e zhvillimit e pasurive në zonat e mbrojtura të aeroportit institucionet ligjzbatuese ndjekin procedurën përmarrjen e masave administrative sipas parashikimeve në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar.

Pika 16 përcakton institucionet që ngarkohen përmirësimin e këtij projektvendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, Agjencia përmirësimi e Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Autoriteti i Aviacionit Civil.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendi është hartuar nga strukturat e Ministrinë Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projektvendimi i është dërguar përmendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Agjencisë përmirësimi e Territorit, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Këshillit Konsultativ qeverisje qendrore – etëqeverisje vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE

Ky projektvendim nuk parashikon të sjellë efekte shtesë përmirësimi buxhetin e shtetit.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRJ

BELINDA BALLUKU

Relacion përmirësimi “Për përcaktimin e rregullave përmirësimi e zhvillimit e zonave aeroportuale”